



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 439/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.10.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Montal” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-60931-06-10-2020, me objekt “*Blerje Aparat Radiografie, krah C (program vaskular)*”, me fond limit 16.666.667 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

Ankimues: “Montal” sh.p.k.
Rruga “Dervish Hima”, 3 Kullat, K3, Shk.1, Ap.9/2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Universitar i Traumës
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Subjekte të Interesuar: “Medfau” sh.p.k.
Rruga “4 Dëshmorët”, 195 Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima façie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përçaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.02.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-60931-06-10-2020, me objekt “*Blerje Aparat Radiografie, krah C (program vaskular)*”, me fond limit 16.666.667 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2. Në datën 13.07.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 23.07.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------|------------------------------|
| 1. “Linear” sh.p.k. | 8.800.000 lekë, skualifikuar |
| 2. “Montal” sh.p.k. | 9.840.000 lekë, skualifikuar |

- | | |
|---------------------------------|-----------------------------------|
| 3. “BNT Electronics” sh.p.k. | 13.118.605 lekë, skualifikuar |
| 4. “Health & Light” sh.p.k. | 14.600.000 lekë, skualifikuar |
| 5. “Albaphoto” sh.p.k. | 14.990.000 lekë, skualifikuar |
| 6. “Medfau” sh.p.k. | 15.400.000 lekë, kualifikuar |
| 7. “Laser - Med” sh.p.k. | 15.640.000 lekë, skualifikuar |
| 8. “Biometric Albania” sh.p.k.. | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.4. Në datën 23.07.2020 operatori ekonomik “Montal” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

Nuk permbush specifikimet teknike pasi nuk perfshihen ne katalog (sipas pikes 2.3 Kapaciteti teknik, germa “f” si me poshte:

- 1.Nuk specifikohet detektori me fibra optike
- 2.Nuk specifikohet mundesia per tre fusha active
- 3.Opsioni per perdorimin e detektorit ne formatet e kerkuara ose te ngjashem nuk shprehet ne katalog.
- 4.Rezolucioni I monitorit ne grafi dhe ne scopi nuk shprehet ne katalog.
- 5.Mungojne informacione mbi tensionin e llampes qe eshte kerkuar 110Kv
- 5.Shperndarja e nxehtesise se anodes nuk shprehet
- 6.Filtrimi I rrezeve X nuk shprehet
- 7.Tek sistemi C Arm nuk specifikohet pjerresimi
- 8.Kendi I shikimit tek monitori nuk specifikohet ne katalog
- 9.Dalje USB per te dhenat nuk shprehet ne katalog
- 10.Nderfaqja Audio(Aux In) dhe Sistemi integruar I zerit nuk shprehet
- 11.Ka mungese informacioni mbi hardëare I PC, nuk jepet asnje e dhene ne katalog
- 12.Ka mungese informacioni mbi Administrimin e ete dhenave te pacientit
- 13.Ka mungese informacioni per Shfaqjen e imazhit, Perpunimin e Imazhit
- 14.Ups I integruar nuk ofrohet
- 15.LSH nuk specifikohet
- 16.Injektori kontrastit I sinkronizueshme me C Arm nepermjet interface

II.5. Në datën 29.07.2020 operatori ekonomik “Montal” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“MONTAL sh.p.k. mori pjese ne proceduren e prokurimit te zhvilluar me date 13.07.2020, nga Spitali Universitar i Traumes Tirane.

Ne date 23.07.2020 jemi njohur me rezultatet e vleresimit te kesaj procedure prokurimi te publikuara nga Autoriteti Kontraktor ne Sistemin Elektronik te Prokurimit si meposhte:

Ne vijim, me date 23.07.2019, jemi njoftuar me mesazh ne SEE per vleresimin e ofertave si.meposhte:

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>BIOMETRIC ALBANIA</i>	<i>0.00</i>	<i>PO</i>
<i>LINEAR</i>	<i>8600000.00</i>	<i>PO</i>
<i>MONTAL</i>	<i>9840000.00</i>	<i>PO</i>

BNT ELECTRONICS	13118605.00	PO
HEALTH & LIGHT	14600000.00	PO
ALBAPHOTO	14990000.00	PO
MEDFAU	15400000.00	JO
LASER MED	15640000.00	PO

Se pari evidentojme faktin qe deri ne daten aktuale, 29.07.2020, qe eshte edhe data e fundit per te paraqitur ankese ndaj vendimit te KVO, nuk na eshte dorezuar ne forme shkresore asnje dokument me sqarime ne lidhje me arsyet e skualifikimit te ofertes tone.

Ne kete suate, jemi te detyruar te paraqesim ankesen tone duke u bazuar ne argumentat e skualifikimit te paraqitura ne sistemin elektronik te prokurimit.

Argumenti i skualifikimit Nr.1

"Nuk permbush specifikimet teknike pas nuk perfshihen ne katalog (sipas pikes 2.3 Kapaciteti teknik, germa "f" si meposhte:

- 1. Nuk specifikohet detektori me fibra optike*
- 2. Nuk specifikohet mundesia per trefusha active*
- 3. Opsioni per perdorimin e detektorit ne formatet e kerkuara ose te ngjashem nuk shprehet ne katalog*
- 4. Rezolucioni i monitorit ne graft dhe ne scopi nuk shprehet ne katalog*
- 5. Mungojne informacione mbi tension in e llanipes qe eshte kerkuar 110 kv*
- 6. Shperndarja e nxehtesise se anodes nuk shprehet*
- 7. Filtrimi i rrezeve X nuk shprehet*
- 8. Tek sistemi C Arm nuk specifikohet pjerresimi*
- 9. Kendi i shikimit tek monitori nuk specifikohet ne katalog*
- 10. Dalje USB per te dhenat nuk shprehet ne katalog*
- 11. Nderfaqja Audio (Aux In) dhe Sistemi i integruar i zerit nuk shprehet*
- 12. Ka mungese infonnacioni mbi hardëare i PC, nuk jepet asnje e dhene ne katalog*
- 13. Ka mungese informacioni mbi Administrimin e te dhenave te pacientit*
- 14. Ka mungese informacioni per shfaqjen e imazhit, perpunimin e imazhit*
- 15. UPS i integruar nuk ofrohet*
- 16. LSH nuk specifikohet*
- 17. Injektori i kontrastit i sinkronizueshem me C Arm nepermjet interface"*

Ne lidhje me Argumentin e Specifikimit Nr. 1 te paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor, evidentojme faktin qe Komisioni i Vleresimit te Ofertave nuk ka konsideruar ne vleresimin e ofertes tone file-in me emertimin "Datasheet.PDF" te ngarkuar ne Seksionin e Dokumentacionit Teknik. Ky file ka madhesi 7.09MB dhe perbehet nga 17 faqe.

Te gjithë argumentat e skualifikimit te penuendura mesiper nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave gjenden te detajuara ne file-in teknik me emertim "Datasheet.PDF" te permendur mesiper. Konkretisht, ju lutemi te gjeni meposhte sqarimet perkatese:

- 1. Nuk specifikohet detektori me fibra optike*

Ky specifikim gjendet ne faqen Nr.3 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku ndodhet ky specifikim.

- 2. Nuk specifikohet mundesia per tre fusha active*

Ky specifikim gjendet ne faqen Nr.3 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku ndodhet ky specifikim.

3. Opsioni per perdorimin e detektorit ne formatet e kerkuara ose te ngjashem nuk shprehet ne katalog.

Ky specifikim gjendet ne faqen Nr.3 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku ndodhet ky specifikim. Nder te tjera eshte specifikuar qe ofrohen formatet 23 cm, 17.25 cm dhe 11 .5cm. Te gjithë formatet e ofruar i tejkalojne specifikimet teknike te kerkuara.

4. Rezolucioni i monitorit ne grafi dhe ne scopi nuk shprehet ne katalog

Ky specifikim gjendet ne faqen Nr. 1 dhe Nr.3 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku ndodhet ky specifikim. Nder te tjera eshte specifikuar qe ofrohet rezolucioni i monitorit prej 4.6lp/mm per dy modalitetet grafi dhe skopi. Rezolucioni i ofruar prej 4.6lp/mm i tejkalon specifikimet teknike te DST te cilat kerkohen perkatesisht $\geq 3.0\text{lp/mm}$ per grafi dhe 2.5lp/mm per skopi.

5. Mungojne informacione mbi tensionin e llampes qe eshte kerkuar 110 Kv

Ky specifikim gjendet ne faqen Nr. 1 dhe Nr.3 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku ndodhet ky specifikim. Nder te tjera eshte specifikuar qe ofrohet tensioni i llampes nga 40kV deri ne 120kV, vlere e cila e tejkalon specifikimin e DST per vleren 110 kV.

6. Shperndarja e nxehtesise se anodes nuk shprehet

Ky specifikim gjendet ne faqen Nr.3 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku ndodhet ky specifikim. Nder te tjera eshte specifikuar qe ofrohet kapacitet ftohes i anodes ne vleren 46480 HU/min nderkohe qe ne specifikimet e DST kerkohet ≥ 35000 HU/min. Kapaciteti ftohes i anodes se ofruar eshte me shurne se 30% me i larte nga ai i kerkuar ne DST.

7. Filtrimi i rrezteve X nuk shprehet

Ky specifikim gjendet ne faqen Nr.3 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku ndodhet ky specifikim. Nder te tjera eshte specifikuar qe ofrohet filter Alumini me trashesi 3.5mm nderkohe qe ne specifikimet e DST kerkohet $\geq 3\text{mm}$. Produkti i ofruar e ploteson dhe tejkalon kete specifikim.

8. Tek sistemi C Arm nuk specifikohet pjerresimi

Ky specifikim gjendet ne faqen Nr.3 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku ndodhet ky specifikim. Nder te tjera eshte specifikuar qe ofrohet pjerresim prej 230° nderkohe qe ne specifikimet e DST kerkohet 220° . Produkti i ofruar e ploteson dhe tejkalon kete specifikim.

9. Kendi i shikimit tek monitori nuk specifikohet ne katalog

Ky specifikim gjendet ne faqen Nr.3 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku ndodhet ky specifikim. Nder te tjera eshte specifikuar qe ofrohet kend shikimi i monitorit-prej 178° specifikim qe perputhet plotesisht me kerkesen ne specifikimet e DST ku kerkohet 178° . Produkti i ofruar e ploteson specifikimin e kerkuar.

10. Dalje USB per te dhenat nuk shprehet ne katalog

Ky specifikim gjendet ne faqen Nr.3 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku specifikohet qarte qe pajisja ofron porte USB sic kerkohet ne specifikimet e DST.

11. Nderfaqja Audio (Aux /11) dhe Sistemi i integruar i zerit nuk shprehet

Ky specifikim gjendet ne faqen Nr.3 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku specifikohet qarte qe pajisja ofron nderfaqe Audio dhe sistem te integruar te zerit sic kerkohet ne specifikimet e DST.

12. Ka mungese informacioni mbi hardëare i PC, nuk jepet asnje e dhene ne katalog Specifikimet mbi hardëare te PC gjenden te specifikuara qarte ne faqen Nr.4 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku specifikohet qarte qe hardëare PC i ofruar ka karakteristikat e meposhtme:

- Operation System 64bit
- RAM 8GB
- Skede grafike me performance te larte per sistem detektimi me rreze-X
- Kapacitet i regjistrimit te imazheve me shume se 100000 ne hard disk pavaresisht madhesisë se imazhit
- Regjistrim i pacienteve ne skedare te vecante
- Kapaciteti i Memories: SSD 384 GB dhe HDD 2TB

Karakteristikat e mesiperme te sistemit hardëare te PC i tejkalojne ndjeshem specifikimet teknike te kerkuara ne DST dhe ofrojne zgjidhje bashkekohore sic eshte memoria me akses te shpejte SSD apo madhësia e memories te perkoheshme e cila ofrohet 8GB (dy-fish i kerkeses se DST).

13. Ka mungese informacioni mbi Administrimin e te dhenave te pacientit

Specifikimet mbi Administrimin e te dhenave te pacientit gjenden te specifikuara qarte ne faqen Nr.4 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku specifikohet qarte qe sistemi i administrimit te te dhenave te pacientit ploteson te gjithë kerkesat meposhte:

- Mundesi (HIS/RIS) per marrjen e te dhenave te ekzaminimeve nga Spitali/radiologjia
- Regjistrim i pacientit te emergjences
- Administrim i studimeve dhe i te dhenave te imazhit
- Regjistrim i imazheve me filtrim dixhital
- Programe te dedikuara me doze te ulet
- Filter bakri shtese per reduktim te metejshem te dozës se pacientit

Eshte ofruar filter shtese Alumini me trashesi 3.5mm.

14. Ka mungese informacioni per shfaqjen e imazhit, perpunimin e imazhit

16. LSH ttuk specifikohet

Specifikimet mbi shfaqjen dhe perpunimin e imazhit gjenden te specifikuara qarte ne faqen Nr.4 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku specifikohet qe shfaqja dhe perpunimi i imazhit ploteson te gjithë kerkesat meposhte:

Shfaqja e imazhit

- Shfaqje e imazhit 1 k x 1 k
- Diafragma dixhitale
- zmadhim dixhital dhe zmadhim fiks
- Rrotullim dixhital i imazhit
- Zoom i detektorit
- LSH (Last Scene Hold) (Pika 16. Ofrohet sipas specifikimit ne faqen Nr.4)
- Invertim i imazhit horizontal dhe vertical
- Invertim i imazhit Positiv/negative
- Rilujtje e videove of scenes dhe funksion automatic i rilujtjes.
- Perpunimi i imazhit
- Korrektim i metalit
- Filtrim per shfaqjen e imazheve me konture te theksuara
- Theksim i kontureve

- Reduktim i zhurmes
- Optimizim dixhital i dendesise
- Shenim R/L
- Matje te distances dhe te kendit

15. UPS i integruar nuk ofrohet

Ne faqen Nr.4 - Ne shtojcen bashkengjitur gjendet evidentimi me ngjyre te kuqe se ku specifikohet qe C-Arrm ofron hapësirë për UPS i cili furnizohet dhe instalohet lokalisht duke qene se pajisjet UPS perbehen nga bateri te cilat jane te rrezikshme per transport. UPS i integruar ofrohet ne perputhje me kerkesat e DST.

17. Injektori i kontrastit i sinkronizueshem me C Arm nepermjet interface"

Injektori i kontrastit eshte i sinkronizueshem nepermjet interface sic specifikohet ne faqen Nr.8. Nder te tjera, pajisja eshte e pajisur me funksion te mbrojtjes se sinkronizuar ne rast bllokimi sic specifikohet ne faqen Nr. 7.

Mjafton te permendim vetem disa shembuj konkrete te specifikime te ofruara te cilat evidentojne qarte qe produkti i ofruar, model OSCAR Prime 23x23 eshte superior ndaj specifikimeve te kerkuara ne tender:

Kerkesa e DST

Panel i sheshte 20x20cm

Madhesia e pikselit: S 200 µm jo me i madh

Matrica 2: 1024 x 1024 piksel

Resolucion ne monitor gjate grafise 2:: 3.0 lp/rnm

Resolucion ne monitor gjate fluoroskopise 2:: 2.5 Ip/mm

Shperndarja e nxehtesise se anodes HU/min: 2:: 35,000

Ne konkluzion, evidentojme faktin qe pajisjet e ofruara, jo vetem qe plotesojne specifikimet e kerkuara ne DST por i tejkalojne ato ne parametrat me te rendesishem qe percaktojne cilesine e pajisjeve.

Sa me siper kerkojme qe oferta e Montal sh.p.k. te klasifikohet si e vlefshme derisa jo vetem ploteson specifikimet teknike te kerkuara ne DST por i tejkalon ato..

Specifikimi i Pajisjes se Ofruar

Ofrohet Panel i sheshte 23x23cm

Ofrohet Madhesia e pikselit 179µm

Ofrohet Matrica 2: 1280 x 1280 piksel

Ofrohet 4.6 lp/mm

Ofrohet 4.6 lp/mm

Ofrohet 46,480 HU/min

II.6. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP, nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr.29/19 prot, datë 05.08.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Montal” sh.p.k., duke e refuzuar atë. Ndërkohë që, operatori ekonomik ankimes në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik pretendon se nuk ka marrë dijeni në lidhje me kthimin e përgjigjes së ankesës së tij. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka argumentuar:

[...]

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në file-in teknik “Datasheet.PDF”, vërehet se faqet 3, 4, 5, 8 janë pjesë e një deklarate të prodhuesit dhe jo pjesë e një katalogu sic kërkohet në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3 “Kapaciteti teknik” ku kërkohen:

Katalogë për artikujt e ofruar ku të përfshihen edhe specifikimet teknike për artikullin e kërkuar. OE duhet të markojë në katalogun përkatës pajisjen që ofron sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës, Katalogët do të pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Neni 63 i LPP, pika 1.1 qartëson se [...]. Nga ana juaj nuk është depozituar asnjë ankesë në lidhje me kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3 Kapacitetit teknik

ku kërkohet paraqitja e katalogëve për artikujt e ofruar. Vlerësimi i ofertave për të gjitha kompanitë pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi është bërë në bazë të katalogëve të paraqitur. Vlerësimi i ofertës tuaj në bazë të një vetëdeklaratë të prodhuesit e paraqitur nga ana juaj, do të ishte në shkelje e nenit 2 të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar. Si përfundim Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi të mos marrë parasysh ankesën tuaj.

II.7. Në datën 10.08.2020 operatori ekonomik “Montal” sh.p.k.. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1656 prot., datë 24.08.2020, protokolluar me tonën në datën 25.08.2020, me objekt “*Informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “*Ne kete shtate, jemi te detyruar te paraqesim ankesen tone duke u bazuar ne argumentat e skualifikimit te paraqitura ne sistemin elektronik te prokurimit. "Nuk permbush specifikimet teknike pas nuk perfshihen ne katalog (sipas pikes 2.3 Kapaciteti teknik, germa "f" si meposhte:*

- 1. Nuk specifikohet detektori me fibra optike.*
- 2. Nuk specifikohet mundesia per trefusha active.*
- 3. Opsioni per perdorimin e detektorit ne formatet e kerkuara ose te ngjashem nuk shprehet ne katalog.*
- 4. Rezolucioni i monitorit ne graft dhe ne scopi nuk shprehet ne katalog.*
- 5. Mungojne informacione mbi tension in e llanipes qe eshte kerkuar 110 kv.*
- 6. Shperndarja e nxehtesise se anodes nuk shprehet.*
- 7. Filtrimi i rrezeve X nuk shprehet.*
- 8. Tek sistemi C Arm nuk specifikohet pjerresimi.*
- 9. Kendi i shikimit tek monitori nuk specifikohet ne katalog.*
- 10. Dalje USB per te dhenat nuk shprehet ne katalog.*
- 11. Nderfaqja Audio (Aux In) dhe Sistemi i integruar i zerit nuk shprehet.*
- 12. Ka mungese infonnacioni mbi hardëare i PC, nuk jepet asnje e dhene ne katalog.*
- 13. Ka mungese informacioni mbi Administrimin e te dhenave te pacientit.*
- 14. Ka mungese informacioni per shfaqjen e imazhit, perpunimin e imazhit.*
- 15. UPS i integruar nuk ofrohet.*

16. LSH nuk specifikohet.

17. Injektori i kontrastit i sinkronizueshem me C Arm nepermjet interface.”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.f “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

“f. Kataloge per artikujt e ofruar ku te perfshihen edhe specifikimet teknike per artikullin e kerkuar. OE duhet te markoje ne katalogun perkates paisjen qe ofron sipas numrit rendor te percaktuar ne formularin e ofertes. Kataloget do te pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.”

III.1.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, është përcaktuar:

Bazuar ne shqyrtimin e ankesave nga ana e OE, AK me ane te kesaj shtojce do te beje ndryshimet ne specifikimet teknike, si me poshte:

➤ Ndryshim specifikimesh teknike Shtojca 10:

ISHTE

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Emertimi: Aparat radiografie, krah C me program vaskular

Poz.	Sistem i levizshem C-Arm me detector me panel te sheshte
	Specifikime teknike te detyruesme si me poshte:
	Detektor i sheshte (8" x 8") 20 cm x 20 cm
	Lidhje me sistemin e perpunimit te imazhit me fiber optike
	Tregues lazer i integruar ne detektor i cili prodhon nje kryq
	Madhesia e pikselit $\leq 200 \mu\text{m}$ jo me i madh
	Dixhitalizimi ≥ 16 bit jo me i vogel
	Matrica $\geq 1024 \times 1024$ piksel
	Grilje $f_0 = 100$ cm
	Mundesesi per tre fusha aktive
	Opsion per perdorimin e detektorit ne formatet 20x20cm, 15x15cm, 10x10cm ose te ngjajshem
	Resolucion ne monitor gjate grafise ≥ 3.0 lp/mm ne te tera fushat aktive
	Resolucion ne monitor gjate fluoroskopise ≥ 2.5 lp/mm ne te tera fushat aktive
	Gjeneratori i rrezeve X
	Diapazoni I kV 40 kV to 110 kV ose ekuivalent
	Imazh tek mA: ≥ 25 mA
	Fluoroscopi e vazhdueshme mA: ≥ 15 mA
	Fluoroscopi pulsuese mA: ≥ 20 mA
	Fluoroscopi e vazhdueshme ≥ 30 f/s
	Llampa e rrezeve X
	Llampe me transformator te tensionit te larte te integruar me nje fokus
	Fusha fokale 0.6 ose ekuivalente
	Te nsoni 110 kV

<i>Shperndarja e nxehtesise se anodes HU/min: $\geq 35,000$</i>
<i>Kapaciteti termik i anodes HU: $\geq 60,000$ HU</i>
<i>Filtrimi i rrezeve X sipas standardit (IEC 601) ≥ 3 mm Al</i>
<i>Matje e integruar e dozës per afishimin e prodhimit doze sipërfaqe ose vlera kerma ne ajer</i>
<i>Opsion qe per cdo pacient vlera e akumuluar te ruhet ne databazen e pacienteve</i>
<i>Kolimator me kolimim pa rrezatim (plumb)</i>
<i>Sistemi i C-arm</i>
<i>Levizje orbitale $\geq 150^\circ$</i>
<i>Pjerresim $\geq (\pm 220^\circ)$</i>
<i>Levizja horizontale ≥ 20 cm</i>
<i>Levizja vertikale ≥ 40 cm e motorizuar</i>
<i>Afishues/ Monitore</i>
<i>Monitor me ngjyra me ndricim te larte 2x19" (48 cm)</i>
<i>Diagonalja e ekranit ≥ 19" (48 cm)</i>
<i>Shfaqja e imazhit 1280x1024 (pixels)</i>
<i>Ndricimi maksimal 650 cd/m²</i>
<i>Raporti i kontrastit $\geq 900:1$</i>
<i>Teknologjia e preferuar LED me ndricim te pasem</i>
<i>Kendi i shikimit horizontal / vertikale $178^\circ / 178^\circ$</i>
<i>Kareli i levizshem i monitoreve</i>
<i>Mundesi per instalimin e dy monitoreve</i>
<i>Dalje USB per te dhenat: USB 2.0</i>
<i>Nderfaqes audio (Aux In)</i>
<i>Lidhje LAN Gigabit</i>
<i>ËLAN / ËiFi 150 Mbit/s IEEE 802.11 a, b, e, g, h, i, n</i>
<i>Kabell fuqie ≥ 5 m</i>
<i>Hardëare i PC</i>
<i>Sistem operacional me 64 bit</i>
<i>RAM ≥ 4 GB</i>
<i>Karte grafike e nivelit profesional e performances se larte for sistemin e detektorit te rrezeve X</i>
<i>Kapacitet ruajtës per $\geq 100,000$ imazhe ne hard disk, pavaresisht nga madhesia e matrices</i>
<i>Te gjithë pacientet e ruajtur ne folder ate vecante</i>
<i>Kapaciteti i hard disk ≥ 2 TB</i>
<i>UPS i pershtatshem i integruar –Burim ushqimi per te dhenat e sistemit te imazhit</i>
<i>Administrimi i te dhenave te pacientit</i>
<i>Mundesi (HIS/RIS) per marrjen e te dhenave te ekzaminimeve nga Spitali/radiologjia</i>
<i>Regjistrim i pacientit te emergjences</i>
<i>Administrim i studimeve dhe i te dhenave te imazhit</i>
<i>Regjistrim i imazheve me filtrim dixhital</i>

<i>Programe te dedikuara me doze te ulet</i>
<i>Filter bakri shtese per eduktim te metejshem te dozës se pacientit</i>
<i>Shfaqja e imazhit</i>
<i>Shfaqje e imazhit 1k x 1k</i>
<i>Diafragma dixhitale</i>
<i>Zmadhim dixhital dhe zmadhim fiks</i>
<i>Rrotullim dixhital i imazhit</i>
<i>Zoom I detektorit</i>
<i>LSH (Last Scene Hold)</i>
<i>Invertim i imazhit horizontal dhe vertikal</i>
<i>Invertim i imazhit Positiv/negativ</i>
<i>Rilujtje e videove of scenes dhe funksion automatic i rilujtjes.</i>
<i>Perpunimi I imazhit</i>
<i>Korrektim i metalit</i>
<i>Filtrim per shfaqjen e imazheve me konture te theksuara</i>
<i>Theksim i kontureve</i>
<i>Reduktim i zhurmes</i>
<i>Optimizim dixhital i dendesise</i>
<i>Shenim R/L</i>
<i>Matje te distances dhe te kendit</i>
<i>Programe dhe hardëare te vecanta te kerkuara</i>
<i>Opsione vaskulare premium / te avancuara</i>
<i>Perftim i imazhit ne Subtraction Angiography (SUB) dhe roadmap (ROAD)</i>
<i>Teknike Roadmap per udhezim te lehte te kateterit, dilatacionit, dhe vendosjes se stenteve</i>
<i>Perftim i imazhit deri 30 f/s</i>
<i>Analize sasiore e eneve dhe analize automatike e eneve</i>
<i>Percaktim i vlerave gjeometrike dhe te dendesise.</i>
<i>Mbivendosje grafike ne kohe reale</i>
<i>Opsion i zhvendosjes se pikseleve</i>
<i>Funksion i matjeve 2D: matje te kendeve dhe distancave.</i>
<i>Nderfaqje per injector kontrasti per idhjen e nje injektori kontrasti</i>
<i>Kerkese automatike per injektim kontrasti pas marrjes se imazhit</i>
<i>Shfaqje e ndryshimeve dinamike gjate injektimit te kontrastit</i>
<i>Celes pedal per leshimin e rrezatimit</i>
<i>Printer me nivele gri: 8 Bit, 256 levels</i>
<i>Printer per leter i series UPP-110HD/SE ose i barazvlefshem</i>
<i>Regjistrues CD / DVD per serite e imazheve dhe fluoroskopine ne regjistrues DVD</i>
<i>DICOM Standard</i>
<i>DICOM Printim</i>

Injektor Kontrasti

Injektim ne nje kend rreth 15 grade nen horizontalen

Me mundesi per ruajtje programesh te personalizuar te injektimit

Ushqimi nga rrjeti 220 – 240V

Volumi maksimal i injektuar jo me pak se 200ml

Injektim i programueshem me hapa jo me te medhenj se 1 ml

Injektim ne diapazonin e presioneve jo me te vogel se 5 deri 20 bar

Injektim me jo me pak se 5 faza

Vonesa e injektimit e programueshme ne diapazonin jo me te vogel se 1 deri 200 sekonda

Operatori Ekonomik te kete Autorizim Prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi.

Garnacia duhet të jetë jo me pak se 2 vjet.

Afati i lëvrimit per pisjen eshte 2 muaj nga data e lidhjes se kontrates.

BEHET:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Emertimi: Aparat radiografie, krah C me program vaskular

Poz.	<i>Sistem i levizshem C-Arm me detector me panel te sheshte</i>
	<i>Specifikime teknike te detyruesme si me poshte:</i>
	<i>Detektor i sheshte (8" x 8") 20 cm x 20 cm</i>
	<i>Lidhje me sistemin e perpunimit te imazhit me fiber optike</i>
	<i>Tregues lazer i integruar ne detektor i cili prodhon nje kryq</i>
	<i>Madhesia e pikselit $\leq 200 \mu\text{m}$ jo me i madh</i>
	<i>Dixhitalizimi ≥ 16 bit jo me i vogel</i>
	<i>Matrica $\geq 1024 \times 1024$ piksel</i>
	<i>Grilje $f_0 = 100$ cm</i>
	<i>Mundesit per tre fusha aktive</i>
	<i>Opsion per perdorimin e detektorit ne formatet 20x20cm, 15x15cm, 10x10cm ose te ngjajshem</i>
	<i>Resolucion ne monitor gjate grafise ≥ 3.0 lp/mm ne te tera fushat aktive</i>
	<i>Resolucion ne monitor gjate fluoroskopise ≥ 2.5 lp/mm ne te tera fushat aktive</i>
	<i>Gjeneratori i rrezeve X</i>
	<i>Diapazoni I kV 40 kV to 110 kV ose ekuivalent</i>
	<i>Imazh tek mA: ≥ 25 mA</i>
	<i>Fluoroscopi e vazhdueshme mA: ≥ 15 mA</i>
	<i>Fluoroscopi pulsuese mA: ≥ 20 mA</i>
	<i>Fluoroscopi e vazhdueshme ≥ 30 f/s</i>
	<i>Llampa e rrezeve X</i>
	<i>Llampe me transformator te tensionit te larte te integruar me te pakten nje fokus</i>
	<i>Fusha fokale 0.6 ose ekuivalente</i>
	<i>Te nsioni 110 kV</i>
	<i>Shperndarja e nxehtesise se anodes HU/min: $\geq 35,000$</i>
	<i>Kapaciteti termik i anodes HU: $\geq 60,000$ HU</i>

	<i>Filtrimi i rrezeve X sipas standardit (IEC 601) ≥ 3 mm Al</i>
	<i>Matje e integruar e dozës për afishimin e prodhimit doze sipërfaqe ose vlera kerma në ajër</i>
	<i>Opsion që për çdo pacient vlera e akumuluar të ruhet në databazën e pacientëve</i>
	<i>Kolimator me kolimim pa rrezatim (plumb)</i>
	<i>Sistemi i C-arm</i>
	<i>Levizje orbitale $\geq 150^\circ$</i>
	<i>Pjerresim $\geq (\pm 220^\circ)$</i>
	<i>Levizja horizontale ≥ 20 cm</i>
	<i>Levizja vertikale ≥ 40 cm e motorizuar</i>
	<i>Afishues/ Monitore</i>
	<i>Monitor me ngjyra me ndricim të lartë 2x19" (48 cm)</i>
	<i>Diagonalja e ekranit ≥ 19" (48 cm)</i>
	<i>Shfaqja e imazhit 1280x1024 (pixels)</i>
	<i>Ndricimi maksimal 650 cd/m²</i>
	<i>Raporti i kontrastit $\geq 700:1$</i>
	<i>Teknologjia e preferuar LED me ndricim të pasëm</i>
	<i>Kendi i shikimit horizontal / vertikal $178^\circ / 178^\circ$</i>
	<i>Kareli i levizshëm i monitoreve</i>
	<i>Mundësi për instalimin e dy monitoreve</i>
	<i>Dalje USB për të dhenat: USB 2.0</i>
	<i>Ndërfaqja Audio (Aux In) dhe Sistem të integruar të zërit me altoparlant dhe ndërfaqje</i>
	<i>Lidhje LAN Gigabit</i>
	<i>ËLAN / ËiFi 150 Mbit/s IEEE 802.11 a, b, e, g, h, i, n</i>
	<i>Kabell fuqie ≥ 5 m</i>
	<i>Hardëare i PC</i>
	<i>Sistem operacional me 64 bit</i>
	<i>RAM ≥ 4 GB</i>
	<i>Karte grafike e nivelit profesional e performancës së lartë për sistemin e detektorit të rrezeve X</i>
	<i>Kapacitet ruajtës për $\geq 100,000$ imazhe në hard disk, pavarësisht nga madhësia e matricës</i>
	<i>Të gjithë pacientet e ruajtur në folder të veçanta</i>
	<i>UPS i përshtatshëm i integruar –Burim ushqimi për të dhenat e sistemit të imazhit</i>
	<i>Administrimi i të dhenave të pacientit</i>
	<i>Mundësi (HIS/RIS) për marrjen e të dhenave të ekzaminimeve nga Spitali/radiologjia</i>
	<i>Regjistrim i pacientit të emergjencës</i>
	<i>Administrim i studimeve dhe i të dhenave të imazhit</i>
	<i>Regjistrim i imazheve me filtrim dixhital</i>
	<i>Programe të dedikuara me doze të ulët</i>
	<i>"Filter shtesë bakri ose alumini për reduktim të mëtejshëm të dozës së pacientit"</i>

	<i>Shfaqja e imazhit</i>
	<i>Shfaqje e imazhit 1k x 1k</i>
	<i>Diafragma dixhitale</i>
	<i>Zmadhim dixhital dhe zmadhim fiks</i>
	<i>Rrotullim dixhital i imazhit</i>
	<i>Zoom I detektorit</i>
	<i>LSH (Last Scene Hold)</i>
	<i>Invertim i imazhit horizontal dhe vertikal</i>
	<i>Invertim i imazhit Positiv/negativ</i>
	<i>Riluajtje e videove of scenes dhe funksion automatic i riluajtjes.</i>
	<i>Perpunimi I imazhit</i>
	<i>Korrektim i metalit</i>
	<i>Filtrim per shfaqjen e imazheve me konture te theksuara</i>
	<i>Theksim i kontureve</i>
	<i>Reduktim i zhurmes</i>
	<i>Optimizim dixhital i dendesise</i>
	<i>Shenim R/L</i>
	<i>Matje te distances dhe te kendit</i>
	<i>Programe dhe hardëare te vecanta te kerkuara</i>
	<i>Opsione vaskulare premium / te avancuara</i>
	<i>Perftim i imazhit ne Subtraction Angiography (SUB) dhe roadmap (ROAD)</i>
	<i>Teknike Roadmap per udhezim te lehte te kateterit, dilatacionit, dhe vendosjes se stenteve</i>
	<i>Perftim i imazhit deri 30 f/s</i>
	<i>Percaktim i vlerave gjeometrike dhe te dendesise.</i>
	<i>Mbivendosje grafike ne kohe reale</i>
	<i>Opsion i zhvendosjes se pikseleve</i>
	<i>Funksion i matjeve 2D: matje te kendeve dhe distancave.</i>
	<i>Nderfaqje per injector kontrasti per idhjen e nje injektorit kontrasti</i>
	<i>Kerkese automatike per injektim kontrasti pas marrjes se imazhit</i>
	<i>Shfaqje e ndryshimeve dinamike gjate injektimit te kontrastit</i>
	<i>Celes pedal per leshimin e rrezatimit</i>
	<i>Printer me nivele gri: 8 Bit, 256 levels</i>
	<i>Printer per leter i series UPP-110HD/SE ose i barazvlefshem</i>
	<i>Regjistruer CD / DVD per serite e imazheve dhe fluoroskopine ne regjistruer DVD</i>
	<i>DICOM Standard</i>
	<i>DICOM Printim</i>

Injektor Kontrasti. Injektori i kontrastit i ofruar duhet te jete kompatibel me sistemin C-arm te ofruar nepermjet nderfaqjes se injektorit te kontrastit, pra i sinkronizuar me te.

Injektim ne nje kend rreth 15 grade nen horizontalen

Me mundesi per ruajtje programesh te personalizuar te injektimit

Ushqimi nga rrjeti 220 – 240V

Volumi maksimal i injektuar jo me pak se 200ml

Injektim i programueshem me hapa jo me te medhenj se 1 ml

Injektim ne diapazonin e presioneve jo me te vogel se 5 deri 20 bar

Injektim me jo me pak se 3 faza

Vonesa e injektimit e programueshme ne diapazonin jo me te vogel se 1 deri 200 sekonda

Operatori Ekonomik te kete Autorizim Prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi.

Garnacia duhet të jetë jo me pak se 2 vjet.

Afati i lëvrimet per pisjen eshte 2 muaj nga data e lidhjes se kontrates.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Montal” sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.
- Dokumentin me emërtimin “Oscar Prime – Specification (2020.02.14)”, të lëshuar nga prodhuesi Genoray Co., Ltd., për procedurën konkrete të prokurimit, në të cilin pasqyrohen specifikimet teknike të artikullit “Aparat radiografie, krah C me program vaskular”, të ofruar nga ky prodhues. (i përkthyer); Katalogun “SinoPoëer-S CT Injectors”, nga prodhuesi Sino Medical – Device Technology Co., Ltd., për artikullim Injektor kontrasti, të përkthyer; Dokumentin “Compliance Sheet”, të lëshuar nga prodhuesi Sino Medical – Device Technology Co., Ltd., për procedurën konkrete të prokurimit, në të cilin pasqyrohen specifikimet teknike të artikullit “Injektor Kontrasti”, të ofruar nga ky prodhues. (i përkthyer).

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.5. Në nenin 27, pika 6 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin “Katalogë për artikujt e ofruar ku të përfshihen edhe specifikimet teknike për artikullin e kërkuar. OE duhet të markojë në katalogun përkatës paisjen që ofron sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogët do të pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit”. KPP sqaron se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këto pajisje.

III.1.7. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Montal” sh.p.k., konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike; Dokumentin me emërtimin “Oscar Prime – Specification (2020.02.14)”, të lëshuar nga prodhuesi Genoray Co., Ltd., për procedurën konkrete të prokurimit, në të cilin pasqyrohen specifikimet teknike të artikullit “Aparat radiografie, krah C me program vaskular”, të ofruar nga ky prodhues. (i përkthyer); Katalogun “SinoPoëer-S CT Injectors”, nga prodhuesi Sino Medical – Device Technology Co., Ltd., për artikullin Injektor kontrasti, të përkthyer; Dokumentin “Compliance Sheet”, të lëshuar nga prodhuesi Sino Medical – Device Technology Co., Ltd., për procedurën konkrete të prokurimit, në të cilin pasqyrohen specifikimet teknike të artikullit “Injektor Kontrasti”, të ofruar nga ky prodhues. (i përkthyer).

Nisur nga arsyet e skualifikimit të pasqyruara në SPE nga autoriteti kontraktor, si dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, KPP sqaron se, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Montal” sh.p.k., konkretisht dokumentit “Oscar Prime – Specification (2020.02.14)”, të lëshuar nga prodhuesi Genoray Co., Ltd., për procedurën konkrete të prokurimit, në të cilin pasqyrohen specifikimet teknike të artikullit “Aparat radiografie, krah C me program vaskular”, të ofruar nga ky prodhues, si dhe dokumentave “SinoPoëer-S CT Injectors” dhe “Compliance Sheet” lëshuar nga prodhuesi Sino Medical – Device Technology Co., Ltd., për artikullin Injektor kontrasti, në të cilin pasqyrohen specifikimet teknike të artikullit “Injektor Kontrasti”, të ofruar nga ky prodhues, gjejnë pasqyrim të gjitha specifikimet teknike të përmendura nga autoriteti kontraktor në arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik “Montal” sh.p.k. Pra, operatori ekonomik “Montal” sh.p.k., me anë të dokumentacionit të paraqitur vërteton se përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, ndryshe nga sa pretendon autoriteti kontraktor. Rjedhimisht, arsyet e skualifikimit të paraqitura nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimit Publik, për operatorin ekonomik “Montal” sh.p.k., nuk qëndrojnë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Montal” sh.p.k., qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Montal” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-60931-06-10-2020, me objekt “*Blerje Aparat Radiografie, krah C (program vaskular)*”, me fond limit 16.666.667 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Montal” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik nga procedura e prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Montal” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 903 Protokolli

Datë 10.08.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri